



Deklaratë për shtyp – 559/07/2020

## Koronavirusi: 23 përqind më pak kriminalitet

**Ministri Reul: Kur jeta publike kufizohet, ndodhin më pak gjëra.  
Reduktimi vlen për të gjitha llojet e veprave penale.**

**Ministria e Brendshme ju komunikon:**

Më pak kriminalitet në Nordrhein-Westfalen: Që nga fillimi i pandemisë së koronavirusit, numri i veprave penale ka qenë dukshëm më i ulët se sa në vitin paraardhës. Midis fillimit të Marsit dhe fundit të Qershorit të këtij viti, janë kryer një total prej 365.676 denoncimesh. Këto janë 107.954 denoncime më pak se sa nga periudha korresponduese e vitit paraardhës. Kjo është ulje me pothuajse 23 përqind. „Kur jeta publike kufizohet, ndodhin më pak gjëra. Më pak denoncime, ky është një zhvillim pozitiv. Edhe nëse këto janë thjesht shifra të përkohshme, ne mund të shohim që tani trendet e para. Rënia vlen për pothuajse të gjitha llojet e veprave penale", u shpreh Ministri i Brendshëm Herbert Reul në një „ Bilanc të përkohshëm koronavirusi" shkurtimisht pas përfundimit të gjysmës së parë të 2020. Në këtë bilanc u diskutua ecuria e krimit gjatë pandemisë dhe ecuria e operacioneve të policisë në lidhje me shkeljet e urdhërësës të mbrojtjes nga koronavirusi.

Numri i vjedhjeve të banesave me thyerje ra me 30 përqind nga 7.561 në 5.290 raste. Numri i vjedhjeve ra në të njëjtën periudhë kohore me 26 përqind nga 3.819 në 2.821. Numri i vjedhjeve të xhepave ra me 39 përqind nga 10.638 në 6.511 raste. Krimet në të cilët individët e moshuar ishin viktimë u ulën me 11 përqind nga 13.550 në 12.104 raste.

Dhuna në familje ra me 21 përqind nga Marsi në Qershor të këtij viti nga 13.230 në 10.479 raste. „Duhet të jemi shumë të kujdesshëm me përcaktimet tona veçanërisht për sa i përket dhunës në familje, dhe të monitorojmë ecuritë nga afër. Por hamendësimi është i qartë : Nëse njerëzit qëndrojnë së bashku në një hapësirë të kufizuar për një kohë të gjatë, do të ketë më shumë raste dhune në familje.

09.07.2020  
Faqja 1 nga 4

Zyra e shtypit e  
kancelarisë së shtetit  
40213 Düsseldorf  
Telefon 0211 837-1134  
0211 837-1405  
ose 0211 837-1151

[presse@stk.nrw.de](mailto:presse@stk.nrw.de)


Gjithsesi, shifrat nuk na lejojnë ende ta nxjerrim këtë përfundim. Është e qartë se policia e NRW po ndjek në mënyrë të vazhdueshme çdo njoftim", u shpreh Ministri.

Ka disa ndryshime në lidhje me mashtrimet dhe vjedhjeve nëpërmjet mashtrimit. „Veçanërisht në ditët e para të koronavirusit, ka patur disa raste ku mashtruesit janë hequr sikur janë punëtorë të departamentit të shëndetit dhe kishin për qëllim të shisnin teste për koronavirusin, 'mashtrimi i nipit në një pallto të bardhë'", u shpreh Ministri.


Shkeljet e urdhëresës për mbrojtjen nga koronavirusi kanë ndodhur kryesisht gjatë pushimeve të pashkëve dhe më së fundmi në fundjavat e shkuara në qytete. Policia ka regjistruar mijëra shkelje dhe 50.587 njerëz midis 25 marsit dhe fundit të qershorit. Prej këtyre, 36.837 ishin të rritur, 11.404 të rinj dhe 2.346 fëmijë. „Shumica e individëve sillen në mënyrë shembullore dhe të disiplinuar. Gjithsesi, pavarësisht ndalimit, ka disa individë të cilët nuk i ndjekin rregullat. Nevoja për ajër të freskët është e kuptueshme, por koronavirusi nuk ka përfunduar ende. Ka kaq shumë qoshe të bukura në Nordrhein-Westfalen, jo çdo person duhet të takohet në qytetin e vjetër", u shpreh Reul.

Ministri ishte pozitivisht i impresionuar nga sjellja e fansave të futbollit gjatë lojërave fantazmë të Bundesligës. Këto u zhvilluan kryesisht pa incidente. „Ishim kuriozë të shihnim si do të reagonin fansat. Dhe jemi të kënaqur për faktin se ata janë sjellur në mënyrë shembullore në shumicën e rasteve. Mbrojtja e shëndetit dhe entuziasmi për futbollin mund të kombinohen mjaft mirë“, u shpreh Reul.

Ministri gjithashtu adresoi takimet kundër urdhëresës për mbrojtjen nga koronavirusi. Në fillim të pandemisë pati protesta kundër ndalimit të kontaktit. Në Maj, gjithsesi, personat të cilët duan të tërheqin vëmendje, personat të cilët merren me teori konspiracioni dhe ekstremistët përfituan nga mungesa e sigurisë dhe në disa raste edhe bënë thirrje për akte kriminale. Më së fundmi, mbledhjet u zhvilluan në qarkun e Gütersloh për shkak të kufizimeve. Në periudhën nga marsi deri në qershor, pati mbi 850 mbledhje në Nordrhein-Westfalen. Kjo kishte pothuajse ekskluzivisht lidhje me kufizimet e vendosura nga urdhëresa për mbrojtjen nga koronavirusi.




Denoncime midis 01.03. dhe 30.06.



Ecuria e numrave të rasteve të shkeljeve të zgjedhura midis 01.03. dhe 30.06. | Burimi: VIVA/IGVP/FINDUS

#CORONA


## INDIVIDËT E IDENTIFIKUAR



Identifikimet sipas grupimeve të moshave , 25.03. deri në 30.06.2020

#CORONA

## SHKELJE



25.03. deri në 30.06.2020: Identifikimet e shkeljeve në lidhje me pandeminë

**Nëse keni pyetje, ju lutemi kontaktoni zyrën e shtypit të Ministrisë së Brendshme, Telefon 0211 871-1111.**

**Kjo deklaratë për shtyp është gjithashtu në dispozicion në internet në adresën e internetit të qeverisë së Republikës [www.land.nrw](http://www.land.nrw)**

**[Njoftim për mbrojtjen e të dhënave në lidhje me rrjetet sociale](#)**